

H Y L L I

I D R I T Ë S

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(II. ad Cor. III 17)

VOTER
KULTURE
SHQIPTARE

4

PRILL 1944
S H K O D Ë R

HYLLI I DRITËS

E përkohëshme kulturore - letrare e përmuejshme
themelue në vjetin 1913 nga A. GJERGJ FISHTA

Drejtimi dhe mbarështrimi: KUVENDI FRANÇESKAN SHKODËR

PAJTIMI PËR NJI VJETË: në Shqipni fr. shq. 30; një numër fr. shq. 4.
Përfashta fr. shq. 40; një numër fr. shq. 5.

PËRMBAJTJA

Dita e Robnís	
<i>F-a</i>	Faqe 1
Me 6 Prill 1911	
<i>Magister</i>	» 6
Hot e Grudë	
<i>Kapit. Gjelosh Luli</i>	» 8
Nikolejda - Poemth herojkomik	
<i>Gegë Toska</i>	» 13
Kulturë e arte në Shqipni	
<i>P. Marin Sirdani o. f. m.</i>	» 18
Fausti i Goethes	
<i>D. L. Shantoja (përkthim)</i>	» 23
Katholicizmi në Shqipni e anmiqt e tij para Gjykatores së historís - Përgjegje Z. N. Ivanaj	
<i>Dr. A. Gjon Shllaku o. f. m.</i>	» 36

HYLLI I DRITËS

E PËRKOHËSHME KULTURORE - LETRARE

DITA E ROBNÍS

E thrasim 7 Prillin «Dita e Robnís».

Atë ditë, vetëm atë ditë, Lirija na u duk si një hyjni që dënon lojtarët e Atdheut, mohuesat e Tokës, sberbtorët e të Huejtit.

Atë ditë pushka e gjaku i Mujos me sa shokë të panjoftun, kuqën prenimin e Liris.

Atë ditë shpërtheu, për herë të parë, Kushtrimi nga gjoksat e rí, e Flamuri i trathtuem u muer me rrëmbim nga dora sengsere dhe valoi disa çase nëpër rrugët e zeza, nëpër rrugët e mveshuna me hije robnije.

Mandej u duk se gjithshka rá në qetsí.

Ushtarët e rí, ushtarët e pastër çelën fshehtas portat e zmravet dhe ndrynë me kujdes Shqipen mijvjeçare.

Tjerët — shum tjerë — grisën një flamur e puthën një tjetër.....

Çëdo 7 Prill Shqiponja e burgosun ndër zemrat e reja trokilloi ke portat e fshehta.

Nepër rrugët e heshtuna, nepër rrugët e mpita kaloi e randë parada e robnís. Prej qoshevet të padijtuna, ndër kohët e paprituna u lëshuen, u mblodhën Flamurtarët e rí.

E kanga, britma, dajaku, pushka shpërthyen e krisën ndër sheshe t' Impero-s.

Pikat e para të gjakut njomën tokën e shkelun, zanet e para të kushtrimit thirrën shpresën e humbun.

Kot njerzit e paguem deshtën me na i kujtue emnat e vjetër, emnat e grindjes: turq e kaurr.

Kot mbi porta të Xhamijavet u vizuen me qellim kryqat dinakë.

Kot edhe shkoi zani i ndonji sherbtori t' ulët, qi një ditë për hesáp të huej, tha pa turp « poshtë Kryqi » ⁽¹⁾.

Të gjithë një goje përgjegjëm :

« Jemi vllazën, s' na ndajn dot ».

Qemë vllazën.....

Dita e parë e robnís na bashkoi, na lidhi. Na bâni me e pá jashta nesh Atdhën e shkelun. Na bâni me e ndie mbrenda nesh zanin e kushtrimit. E kur armët nuk arrinë deri ke krahët e rí, lotët zhbërthyen rrakajë para një Flamuri të kuq me Shqipe të zezë.

Atë ditë e ndiem se ishim Shqiptarë.

Vetëm Shqiptarë.

Qemë vllazën.

Ndër ditët e fundit të robnís harruem ditën e parë. Harruem se çëdo i huej u kqyr si anmik. Si zotní qi vjen me rregjistruer rob. Harruem se çëdo 7 Prill u ndám me kufi në tokën e robnueme, u kqyrëm me mēní, u gjuejtëm me fjalë, me gur, me plumba.

Na, qi s' mujshim me pá një të huej pa e numrue shkaktár robnije, ndasije, pa e zhgjetue me shikime mosbesimi, inati, na pranuem në folët t' ona kryengritse njerzë, flamuj e urdhna të huej.

Urdhnat e huej shkuen në vend.

Fakt historik ngjá në Korçë.

